



Datë: 06.11.2025
Numër Protokolli: 7229/2025

A.nr.1694/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr. 1694/2025, të datës 15.09.2025, të parashtruar nga ankuesja L.R, kundër organit të punësimit Ministra e Industrisë, Ndërmarrësis dhe Tregtisë, në çështjen juridike “*transferim*” duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1694/2025, e datës 15.09.2025 e parashtruar nga ankuesja L.R, ndërsa çështja kthehet në **Rishqyrtim** dhe rivendosje tek organi kompetent i Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësis dhe Tregtisë, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatim duke ju referuar arsyetimit të këtij vendimi.

II. Anulohet Vendimi me numër Ref.02/Nr.216, i datës 02.09.2025, i U.D Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësis dhe Tregtisë, për transferimin e ankueses në pozitën recepsionistë.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Nëpunësja civil L.R (në tekstin e mëtejme referuar: ankues) me datë 15.09.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 216, të datës 02.09.2025 të UD Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësis dhe Tregtisë, lidhur me transferimin e përkohshëm nga pozita “*Zyrtare Ligjore*”, në pozitën “*Recepsioniste*”, në kuader të Departamentin të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësis dhe Tregtisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave, më datë 23.09.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industrisë Ndërmarrësis dhe Tregtisë, ndërsa kjo e fundit, më datë 25.09.2025 ka përcjellë shkresat e lëndës lidhur me çështjen ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 6140/2025 të datës 15.09.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Emalin e datës 04.09.2025; Aktvendimin me numër protokollit 5752/2025 të datës 28.08.2025; Dokumentin e identifikimit të ankueses; Vendimin me numër 5056/2025 të datës 24.07.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 23.09.2025; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1694/2025 të datës 25.09.2025; Vendimin me numër Ref.01/Nr.62 të datës 13.08.2025; Ndryshim dhe plotësimin e aktit të emërimit të datës 11.04.2019; Vendimin me numër 881/02 të datës 02.09.2025; Vendimin me numër Ref.02/NR.211 të datës 29.08.2025; Emalin e datës 03.09.2025; Autorizimin e datës 01.10.2025; Dëshmitë mjekësore; Emalin e datës 01.10.2025 të L.R drejtuar B.I; Emil-et e datës 02.10.2025 të L.R drejtuar E.K; Emalin e datës 02.10.2025 të L.R drejtuar N.SH; Aktvendimin me numër A.nr.2778/2025 të Gjykatës Themelore në Prishtinë;

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe pretendimeve ankimore të ankueses, ka gjetur se ankesa është e **bazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesja sipas ndryshim dhe plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 11.04.2019, është e punësuar në pozitën ‘ *Zyrtarë Ligjore 2* ’, në Inspektoratin e Tregut, në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësis dhe Tregtisë. Tutje U.D Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësis dhe Tregtisë, përmes Vendimit me numër Ref.02/Nr.216, të datës 02.09.2025, ankuesen e ka transferuar me mënyrë të përkohshme nga pozita “*Zyrtare Ligjore*”, në pozitën “*Receptioniste*” në Departamentin e Shërbimeve të Përgjithshme, në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësis dhe Tregtisë, për periudhë prej gjashtë (6) muaj, me mundësi vazhdimi deri në dymbëdhjetë (12) muaj pa u dëmtuar në pagën bazë aktuale si dhe me arsyetimin për interes të institucionit .

Ankuesja L.R, e pakënaqur me vendimin me Nr. Ref.02/216 , të datës 09.02.2025 të U.D Sekretarit të Përgjithshëm së Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësis dhe Tregtisë, me datë 12.09.2025 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila në Këshill është pranuar me date 15.09.2025, kundër vendimit lidhur me transferimin e përkohshëm të nxjerr nga U.D Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësis dhe Tregtisë, me pretendimet ankimore se vendimi me numër Ref.02/Nr.216 i datës 02.09.2025 lidhur me transferim ka të bëjë me shkelje procedurale vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim jo të drejtë të drejtës materiale, pasi që pozita në të cilën është transferuar ankuesja pretendon se është pozitë e kategorisë së stafit mbështetës/teknik.

Referuar kuadrit ligjor si me sipër, e në mbështetje të nenit 86 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit ka analizuar aktin e kundërshtuar më ankesë në ndërlidhje me provat materiale të kësaj çështje administrative ku si rrjedhojë ka gjetur se Vendimi i kontestuar është nxjerrë nga Ushtruesi i Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, i emëruar sipas Vendimit Ref.01/Nr.62 të datës 13.08.2025, të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Në kuptim të kompetencës ligjore të organit që ka nxjerrë aktin e kundërshtuara më ankesë, Kolegji iu referua nenit 35 të Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: 1. *Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë.* 2. *Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit.* 3. *Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë.* 4. *Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni.* 5. *Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të*

përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm”. Rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji ka konstatuar së më Vendimin Ref.01/Nr.62 të datës 13.08.2025, të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, zyrtari A.Xh i cili sipas Aktit të Emërimit ushtron pozitën e *Udhëheqës në Laboratorin e Vëllimit dhe Rrjedhës në Agjencinë e Meteorologjisë së Kosovës* është caktuar ushtrues i detyrës Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe atë me afat të pacaktuar. Gjegjësisht, vendimi Ref.01/Nr.62 i datës 13.08.2025, është nxjerrë mbi bazën e nenit 10 dhe 11 të Ligjit të Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, e që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit akti i kontestuar është nxjerrë më bazë të gabuara ligjore sepse emërimi i ushtruesve të detyrës në rastet ku pozita është e lirë behët vetëm në pajtim me dispozitat e nenit 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, dhe si rrjedhojë dispozitat e Ligjit Nr./L-113 për Organizmin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura zbatohet vetëm në rastet kur mbajtësi i pozitës përkohësisht nuk mund ta ushtroj pozitën e tij për shkaqe të caktuara(pushim vjetor apo mjekësor, trajnim, etj.).

Po ashtu për vendosje të drejtë Kolegji mori parasysh edhe dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, konkretisht nenit 9 paragrafi 1,3,dhe 4, përcakton se *1. Në rast se një pozitë e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësi i nivelit të lartë drejtues i atij institucioni e cakton me vendim ushtruesin e detyrës për pozitën e lirë. Për kategorinë e nivelit të lartë drejtues, ushtruesin e detyrës e cakton titullari. 3. “Zyrtari publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se dymbëdhjetë(12) muaj përveç rasteve kur procedura e rekrutimit është shpallur por për arsye objektive pozita nuk është plotësuar”. Paragrafi 4 i nenit 35 të ligjit bazik ndryshohet si në vijim: 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se një periudhë prej dy (2) viteve.*

Andaj, nisur nga rrethanat si më sipër Kolegji rithekson faktin se caktimi i ushtruesit të detyrës në pozitë të kategorisë së lartë drejtuese, duhet të bëhet në përputhje me kriteret ligjore, pra si ushtrues detyre mund të caktohet vetëm nëpunësi që është i kategorisë më të lartë pasuese ekzistuese, dhe jo me gjatë se 12 muaj (nëse caktimi është berë pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji), e që në rastin konkret si ushtrues detyre i Sekretarit të Përgjithshme të MINT duhet të ishte zyrtari nga kategoria e mesme drejtues dhe atë brenda strukturës së Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa, zyrtari i emëruar për ushtrues detyre të Sekretarit të Përgjithshëm vë nga kategori e ulët drejtuese. Kështu që, mbi këto fakte dhe rrethana rrjedhë së emërimi i ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MINT sipas Vendimit 01/Nr.62 të datës 13.08.2025, është në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 35 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ndërlidhur me nenin 9.3 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Mbi bazën e këtyre rrethanave, Kolegji i Këshillit konstatoi se nxjerrja e vendimit të atakuar më ankesë është veprim i ndërmarr nga organi më mungesë të kompetencës ligjore dhe si i tillë konsiderohet si veprim i paligjshëm në kuptim të nenit 52, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që, nisur nga ky shkak ligjor Kolegji nuk u lëshua në trajtimin e pretendimeve tjera ankimore të ngritura në ankesë, pasi që vet mungesa e autorizimit ligjor të organit që ka nxjerr aktin e goditur më ankesë, e bënë në tërësinë e tij aktin juridikisht të pavlefshëm.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA A.nr.1694/2025

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit me autorizim avokat Alban Krasniqi;
- Ministres-së, Ministrisë se Industrisë Ndërmarrësis dhe Tregtisë
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrisë se Industrisë, Ndërmarrësis dhe Tregtisë ; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.